


KRAHASIMI I PAGAVE



SHKELJET KRYESORE TË TË DREJTAVE TË PUNËTORËVE

- Mos pagesa e pagës statutore minimale për rreth 50% të punëtorëve.
- Mos zbatimi i rregullave për orët shtesë dhe pagesën e tyre.
- Mos zbatimi i rregullave të lejes vjetore dhe asaj në rast sëmundje.
- Hendek i konsiderueshëm midis pagës aktuale dhe pagës së nevojshme për jetesë.
- Keqtrajtim i punëtorëve (të bërëtitura, frikësim, dhunë seksuale).
- Mos zbatim i rregullave në lidhje me shëndetin dhe sigurinë në punë.

EKONOMIA QË RRIETET ME RITMET MË TË SHPEJTA NË EUROPË DHE QË KA NDËR KUSHTET MË TË KËQIJA TË PUNËS DHE VARFËRINË MË TË LARTË

Industria e veshmbathjes në Shqipëri është e karakterizuar nga një pozicion dominues brenda ekonomisë për sa u përket eksporteve (rreth 35%) dhe punësimit, si dhe, në të njëjtën kohë, për sa u përket shqetësimeve të konsiderueshme në lidhje me kushtet e punës dhe shpërblimit. Shkeljet e kodit të punës janë rregull jo përjashtimi. Pandëshkueshmëria në lidhje me shkeljet ligjore dhe të drejtave të njeriut është shumë e përhapur. Pavarësisht një page mujore neto minimale ligjore shumë të ulët prej 140 Euro, një në dy të intervistuar nuk e ka fituar këtë sasi minimale gjatë orarit të rregullt të punës. Inspektimet shtetërore të punës nuk funksionojnë në mënyrë efektive në sektor. Për më tepër, marrëdhëniet ndërmjet pronarëve të fabrikave dhe zyrtarëve të qeverisë si dhe si dhe ato ndërmjet pronarëve të fabrikave dhe përfaqësuesve të sindikatave janë marrëdhënie korruptive. Edhe pse Shqipëria është lavdëruar nga Banka Botërore, si ekonomia me rritjen më të shpejtë në Evropë, zyra e Avokatit të Popullit, gjatë kryerjes së një rrjeti të gjerë detyrash në mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve, pajiset me fonde publike të pamjaftueshme, që do të thotë se duhet të mbështetet pjesërisht në ndihma zyrtare zhvillimore nga jashtë. Shqipëria ka disa nga normat më të larta të varfërisë në Evropë.⁹ Punëtorët e industrisë së veshmbathjes nuk kanë përfituar nga bumi në industri; pagat që ata fitojnë nuk ndihmojnë në zbutjen e varfërisë dhe as parandalojnë varësinë.

INDUSTRIË E VESHMBATHJES NË SHQIPËRI

Industrië e veshmbathjes në Shqipëri kanë qenë sektorët e saj kryesorë të eksportit për më shumë se 15 vjet, dhe vazhdojnë të rriten me ritme të shpejta. Eksportet e këpucëve janë dyfishuar gjatë 5 viteve të fundit dhe eksportet e veshjeve janë dyfishuar gjatë 10 viteve të fundit.

Spektori shqiptar i veshmbathjes punon sipas sistemit OPT (Skema e Tregtisë së Përpunimit dhe Prodhimit për Jashtë, krijuar nga Gjermania dhe BE-ja në vitet 1970 për të mbrojtur industrië të tyre të tekstilëve). Në Shqipëri kjo qasje e nënkontraktimit të prerje-bërje-regullimit e orientuar drejt eksporteve quhet Fason. Më shumë se 80% e veshjeve dhe këpucëve eksportohen në Itali, e ndjekur nga Gjermania dhe Greqia me vetëm 7% dhe 8% përkatësisht. Pronarët italianë gjithashtu dominojnë investimet e huaja në këtë sektor. Në vitin 2015 Shqipëria eksportoi 11.2 milionë palë këpucë në Itali (World Footwear Book 2015).

Në një fabrikë këpucësh, punëtorët thanë që duhet të përfundojnë 550-600 palë këpucë çdo ditë.

Prodhimi i veshjeve dhe këpucëve sipas metodës OPT është një industri me paga të ulëta dhe vlerë të pakët të shtuar ndaj nuk qendron lart në statistikën e PBB apo eksporteve. Megjithatë, ky sektor është punëdhënësi më i madh në Shqipëri, duke nxënë 45% të forcës punëtore të industrisë prodhuese.¹⁰ Prodhimi i veshmbathjeve në vend përqendrohet rreth rajonit të Tiranës dhe Durrësit. Forca punëtore në industri është relativisht e re (31 vjeç mesatarisht sipas Dhomës së Fasonëve të Shqipërisë), ndërkohë që në vende të tjera me paga të ulëta në Evropë rrobaqepëset janë zakonisht ndërmjet 40 dhe 55 vjeç.

Bordi shtetëror i Investimeve, AIDA, citon një sërë faktorësh si avantazhin konkurrues të sektorit: fleksibilitetin dhe besueshmërinë e prodhimit, kohën e shkurtër të dorëzimit në vendet e BE-së, “kosto konkurruese pune” për shkak të pagave të ulëta krahasuar me vendet e tjera të rajonit dhe aftësitë e shkëlqyera për gjuhët e huaja të pjesës më të madhe të punëtorëve, bashkë me politika “mbështetëse” qeveritare për sektorin. Në fakt, ky sektor përfiton nga një paketë incentivash dhe subvencionesh. Investitorët e orientuar kah eksportin promovohen dhe u jepen incentiva të konsiderueshme.¹¹ Dhoma Shqiptare e Fasonëve si edhe Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) kanë lobuar suksesshëm për tre zona të lira ekonomike dhe skema incentivash. Ndër to mund të përmendim: kontratë simbolike qeraje 1 Euro për pronat qeveritare për herën e parë; rimbursim të shpejtë të TVSH; përjashtim nga TVSH për makineritë dhe pajisjet; thjeshtim të procedurave doganore, investimeve, punësimit dhe sigurimeve shoqërore; subvencione për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore për punonjësit e rinj për një periudhë të caktuar si edhe përfaqësim të privilegjuar të sektorit në Këshillin Kombëtar Ekonomik (organ tripalësh pa fuqi vendimmarrëse). Dhoma e Fasonëve shton se ka arritur “reformë të sistemit referues krahasimor të punësimit në marrëdhënie me pagat për industrinë”.¹²


A PËRFITOJNË PUNËTORËT NGA KUSHTET FAVORIZUESE PËR PUNËDHËNËSIT E SEKTORIT TË VESHMBATHJEVE?

Këto incentiva dhe subvencione tregojnë një politikë sipas të cilës të drejtat e investitorëve privilegjojnë në kurriz të të drejtave të punëtorëve dhe faktit që AIDA dhe Dhoma e Fasonëve e përdorin influencën e tyre për të penguar progresin e të drejtave në vendin e punës dhe pagave. Këto incentiva dhe subvencione i janë punëdhënësve të industrisë pa u konsultuar me aktorë të tjerë si avokati i popullit¹³ apo organizatat e të drejtave të njeriut. Ndaj situata e punëtorëve është ndër më të këqijat në Evropë dhe në botë, sikurse tregojnë edhe të dhënat më poshtë.

Një në tre të intervistuar nuk merr pagën minimale – edhe duke llogaritur orët shtesë dhe bonuset. Për shkak të mbizotërimit të orëve shtesë mund të arrihet në përfundimin se të paktën 50% e forcës punëtore në këtë sektor nuk merr pagë minimale gjatë orëve normale të punës. Krahasuar me vendet e tjera pjesë të këtij studimit, Shqipëria dallon si një vend ku dita e shtunë është ditë normale pune, jo përjashtim. Punëtorët nuk e konsiderojnë këtë si orë shtesë. Kjo do të thotë se java e punës i tejkalon 40 orë pune ligjrisht të lejueshme, se orët shtesë nuk paguhet sipas normës ligjore (25 dhe 50%) dhe se pagat nuk janë transparente për punëtorët.

Paga minimale në Shqipëri ka mbetur e pandryshuar që nga viti 2013 (22 000 Lek bruto – 158 Euro). Asnjë rregullim nuk është bërë në këtë kohë. Këshilli Kombëtar i Punës – teorikisht një organ trepalësh këshillimor tek Ministria e Punës – ka qenë tepër i dobët,¹⁴ por është rivendosur në punë në vitin 2015 pas ndërhyrjeve të ILOs. Deri këtë vit, Shqipëria ishte i vetmi vend

PAGA
MINIMALE
LIGJORE



si pjesë e pagës
minimale të
jetesës

në rajon ku nuk kishte negociata tripalëshe për dialog në nivel kombëtar mbi punën apo çështje sociale, veçanërisht sa i përket pagës minimale. Megjithatë, negociatat tripalëshe nuk funksionojnë siç duhet nëse zëri i organizuar nuk ngrihet në favor të punëtorëve. Përkundrazi, studimi i literaturës nuk tregoi për ndonjë rekomandim nga ana e sindikatave mbi pagën minimale apo përlllogaritjet e kryera prej tyre mbi kostot e jetesës. Punëtorët e intervistuar i asocionin sindikatat me pronarët e fabrikave.

Një tjetër barrierë për rregullimin e pagës minimale ligjore për të mbuluar shpenzimet reale është mungesa e statistikave zyrtare mbi kostot e jetesës apo minimumin socio-kulturor për të mbuluar nevojat bazike. Mungesa e vullnetit politik për të rregulluar pagën minimale që t'i përshtatet shpenzimeve reale ka çuar në një sërë ankesash nga qytetarët drejtuar avokatit të popullit, së bashku me kritika nga ILO dhe që nga ajo kohë Shqipëria ka përjetuar një diskutim në rritje të kësaj tematike.¹⁵



e forcës punëtore në sektor nuk merr pagën minimale gjatë orëve të rregullta të punës

SHKELJET MË TË ZAKONSHME TË KODIT TË PUNËS DHE TË DREJTAVE TË NJERIUT PËEFSHIJNË:

- Mos pagesa e pagës minimale brenda 40 orëve të rregullta të punës në javë. (Në 1 fabrikë vetëm 10% e punëtorëve marrin pagën minimale, ndërkohë që pjesa tjetër merr më pak; në një fabrikë tjetër asnjë prej punëtorëve të intervistuar nuk merrte pagën minimale).
- Burrat paguhen më tepër se gratë për të njëjtën punë dhe performancë – me justifikimin se “janë më të fuqishëm”
- Penalizmi i punëtorëve përmes zbritjes së pagës (heqje e orës apo ditës së punës) kur produktet dëmtohen ose kur punëtori vjen me vonesë në punë
- Mos pagesa e kontributeve shoqërore të detyrueshme
- Mos pagesa e orëve shtesë ose normave premium
- Të gjithë punëtorët raportuan se nuk bëjnë orë shtesë ndërkohë që raportojnë gjithashtu se e shtuna është ditë normale pune, që do të thotë se kjo nuk shihet si orë shtesë
- Marrja e 3 deri në 15 ditë pushim vjetor, por jo 20 ditët që parashikohen me ligj
- Leja vjetore shpesh përcaktohet nga drejtuesit dhe nuk paguhet
- Ditët zyrtare të pushimit paguhen njësoj si ditët normale të punës
- Leje pa pagesë për ditët e festave kombëtare
- Asnjë shpjegim për mënyrën si llogariten pagat, veçanërisht orët shtesë
- Kur nuk ka porosi punëtorët detyrohen të qendrojnë në shtëpi dhe pa të drejtë page
- Punëtorët nuk kanë një kopje të kontratës së tyre dhe shpesh as nuk lejohen të lexojnë atë
- Ankesat ndëshkohen me heqje nga puna
- Marrja e një dite pushim për arsye shëndetësore ose familjare është tejet e vështirë
- Temperaturat ekstreme (ndonjëherë kondicionerët nuk ndizen fare)
- Ajri i ndotur prej substancave toksike
- Nuk ofrohet ujë i pijshëm

Së fundi, Komisioni Evropian e pengon rritjen e pagës minimale. Veçanërisht pas krizës financiare të 2008 – 2009 sikurse vendet e tjera të rajonit Shqipëria është detyruar të marrë hua nga Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN), Banka Botërore dhe Komisioni Evropian (të cilat së bashku formojnë të ashtuquajturën trojka). Një kusht i këtyre huave ishte që pagat dhe pensionet në sektorin publik duhet të ngriheshin ose zvogëloheshin –

Puna në terren dhe shfletimi i literaturës u kryen gjysmën e dytë të vitit 2015. Tre fabrika këpucësh dhe 1 fabrikë veshjesh u zgjodhën me 57 punëtorë të intervistuar të moshës 16 deri 58 vjeç, ndër to një burrë. Sipas punëtorëve dhe kërkimit online, markat të cilat furnizohen nga fabrikat përfshijnë: **Bata, Zara, Liu Jo.** Kërkueset arritën në përfundimin se është pothuajse e pamundur të gjesh markat specifike dhe blerësit e përfshirë pasi etiketa nuk vendoset në Shqipëri.

pavarësisht faktit që punonjësit e sektorit publik si mësuesit, kishin paga të ulëta dhe detyroheshin të bënin disa punë ose të emigronin në mënyrë që të mbanin familjet. Këto masa që i përkasin fitimeve të sektorit publik gjithashtu ushtronin presion tek pagat e sektorit privat dhe vendosjen e pagës minimale.¹⁶

Shumë raste sëmundjesh, gjendje dobësie, helmim dhe alergji si edhe aksidente të ndryshme raportohen në fabrikat e këpucëve. Një punëtorë këpucësh që përdor mastiç në procesin e bërjes së këpucës u shpreh se vënia e dorezave redukton precizionin dhe shpejtësinë e punës së saj dhe ul cilësinë e këpucëve, që është edhe arsyeja pse nuk mund t'i përdorë ato nëse do të arrijë kuotën dhe cilësinë e duhur. Ndaj pagesa sipas palëve të këpucëve që prodhohen dhe pritshmëritë e larta sa i përket produktivitetit përbëjnë sfida kyçe për përdorimin e pajisjeve mbrojtëse.

Ekziston **diskriminim** në bazë gjinore dhe etnike: në një nga fabrikat e këpucëve, 65% e punëtorëve ishin nga minoriteti Rom dhe Egjyptian; gratë paguhen më pak se burrat për të njëjtën punë dhe performancë; burrat punojnë kryesisht me makineritë e rënda, një punë që paguhet në bazë të orëve të punës dhe që për rrjedhojë përkthehet edhe në pagë më të lartë. Pagat e raportuara të burrave ishin 35 000 Lek/251 Euros ndërkohë që pagat e grave ishin rreth 20 000 Lek/143 Euro, duke përfshirë bonuset dhe orët shtesë. Ndonjëherë gratë i kërkojnë punëdhënësve të mos paguajnë kontribute shoqërore pasi e perceptojnë këtë si mënyrë për të marrë më tepër para në dorë. Studiueset shprehën shqetësim rreth dhunës së shpeshtë gjinore, por ishte e vështirë të dallohej qartësisht pasi gratë nuk flasin shumë rreth saj.

Sektori informal i ekonomisë llogaritet mesatarisht 36.2% e PBBsë gjatë periudhës 1996 – 2012 (INSTAT, 2013) me një rritje gjatë vitit paraardhës. Kjo përqindje është zakonisht më e lartë për industrinë e veshmbathjeve se sa për ekonominë në tërësi; autorët vlerësojnë se 50-70% i numrit total të vendeve të punës në industrinë e veshmbathjeve është informal; pa të drejtat ligjore dhe mbrojtjen përmes një kontrate pune apo kontribute shoqërore. Punëtorët e paregjistruar (sidomos më të rinjtë dhe ata që sapo kanë filluar punë) marrin ndërmjet 14 000 Lek/100 Euro në muaj dhe 18 000 Lek/129 Euro në muaj. Rezultatet e punës në terren dhe shfletimit të dokumenteve tregojnë se nivelet më të ulëta të zinxhirit të prodhimit përfshijnë punën në shtëpi dhe punën e fëmijëve. Megjithatë, që prej shtatorit të vitit 2015 qeveria shqiptare ka ritur përpjekjet për të reduktuar punësimin e paregjistruar. Megjithatë, perceptohet si normale të punosh pa një kontratë dhe heqin vetë dorë nga kontributet e detyrueshme në përpjekje të dëshpëruar për të marrë më tepër para për shpënzimet ditore. Këto punëtorë informalë pa sigurime shoqërore mbeten në pozitë tepër të rrezikuar pa mundësinë e shtetit për t'i mbrojtur nga probleme të ndryshme jetësore (sëmundje, moshë e tretë, papunësi). Sistemi i sigurimeve shoqërore po gërryhet, që në këmbim rezulton në peshë më të madhe të punës së papaguar të grave. Përveç presionit për të qendruar në punë të paguara (edhe pse të nënpaguara si në fabrikat e këpucëve dhe veshjeve), gratë përballen me nevojën në rritje për të mbushur mungesën e investimeve shtetërore në "infrastrukturën sociale". E kombinuar kjo me tendencën e të rinjve dhe në veçanti të atyre më mirë të edukuar për të emigruar, deficit i përkujdesjes do të rritet pa dyshim dhe do të shndërrohet në sfidë të madhe. Mos pagesa e sigurimeve shoqërore do të thotë gërryerje të një strukture shtetërore që është gjithësi e brishtë dhe vendosje të peshës dhe përgjegjësisë tek gratë.

Nëse punëtorët fitojnë pagën minimale, ata marrin 24% të minimumit të jetesës. Për shkak të papunësisë së lartë, pjesa më e madhe e punëtorëve (shumica gra) janë të vetmit që sjellin të ardhura në shtëpi. Kjo do të thotë se gratë duhet të mbajnë familjet me të ardhura të ulëta. Paga minimale bruto shqiptare në euro është shumë më e ulët se ajo e Kinës ose Indonezisë dhe rreth 10% e minimumit gjerman.

Ndërkohë që një punëtor shqiptar duhet të punojë 1 orë në mënyrë që të blejë një litër qumësht, një punëtor gjerman e përballon këtë blerje pas 6 minutash punë

A mund ta ndryshojnë sindikatat këtë situatë për të arritur kushte më të mira pune? Punëtorët e disa fabrikave raportojnë se sindikatat kanë marrëdhënie të mira me drejtuesit dhe mund të marrin "dhuratat" në këmbim të mos krijimit të problemeve. Asnjë prej punëtorëve të intervistuar nuk ishte pjesë e një sindikate apo të dinte si t'i afrohej atyre; studiuesve iu treguan raste të marrëdhënieve korruptive financiare ndërmjet pronarëve të fabrikave dhe sindikalistëve. Të intervistuarit gjithashtu morën informacion se punëtorët nuk flasin me njëri-tjetrin për shkak të frikës se mund të "spiunohen" tek drejtuesit. Në Shqipëri punëtorët nuk organizohen pasi kanë frikë nga njëri-tjetri.

Nuk arritëm të merrnim informacion mbi inspektimet e inspektoratit të punës brenda industrisë së këpucëve apo rezultatet e tyre. Asnjë prej punëtorëve të intervistuar nuk ishte përfshirë në inspektime. Të intervistuarit nga një fabrikë kishin marrë pjesë në një trajnim mbi sigurinë nga zjarri. Të intervistuarit nga një fabrikë këpucësh nuk ishin përfshirë në asnjë trajnim mbi sigurinë shëndetësore në punë. Inspektorët e punës shihen të marrin rryshfet në mënyrë që të mos kontrollojnë kushtet reale të punës; punëtorët e paregjistruar fshihen në dhoma të veçanta. Duke pasur parasysh rreziqet e shumta shëndetësore në industrinë e këpucëve procesi i inspektimit të punës mund të konsiderohet jo efikas.

Kishte punëtorë shqiptarë që madje ishin dakord të tregonin emrat e tyre pasi mendonin se situata e tyre ishte kaq e dëshpëruar sa nuk kishin asgjë për të humbur. "Ju lutem na ndihmoni" ishte një prej thirrjeve që një punëtor i drejtoi studiuesve.

ANA (EMRI I NDRYSHUAR): E VETMJA GJË QË KËRKOJMË ËSHTË PAK DINJITET NË PUNËN TONË

Familja e Anës përbëhet nga 4 anëtarë: Ana, bashkëshorti i saj dhe dy fëmijët e tyre, një djalë 10 vjeç dhe një tjetër ende në kopësht. Në këtë familje prej 4 personash Ana është e vetmja që punon (e punësuar në një fabrikë këpucësh me një rrogë tejte të ulët prej 150 eurosh) ndaj edhe është i vetmi burim të ardhurash për familjen. Ajo ka 8 muaj në këtë fabrikë. Më parë ishte bashkëshorti i saj ai që punonte për familjen, i punësuar në sektorin e ndërtimit. Kur puna e tij filloi të bëhej gjithnjë e më e paqendrueshme, duke kaluar nga një kompani në tjetrën dhe duke punuar shpesh me kontrata afatshkurtra, nuk kishte zgjidhje tjetër për të, ndaj filloi të kërkonte punë. Ana operon një makineri të rëndë që qep pjesën e përparme të këpucës. I duhet të qendrojë në këmbë 8 orë në ditë, 6 ditë në javë për të arritur kuotën e përcaktuar. Edhe pse nuk paguhet shtesë, shpesh i kërkohet të bëjë edhe detyra të tjera. Dy aspektet më të rënda të punës së saj janë: ajo ankohet se drejtuesit nuk i trajtojnë punonjësit e tyre si qenie njerëzore.

1. Shpesh i abuzojnë ata fizikisht dhe verbalisht (duke i ofenduar gratë me epitete të tilla si: "bushtër", "idiote", "të rëntë kanceri" etj). Kjo i zvogëlon ata, i bën të ndjehen skllëvër duke e bërë edhe punën të paretshme, me staf që duhet të durojë kritika të ashpra dhe sharje përgjatë ditës. Së dyti, paga nuk mjafton për një person, jo më për një familje prej 4 vetash me dy fëmijë të vegjël që kanë nevoja por edhe dëshira ndërkohë që rriten. Ajo nuk do ta zgjidhte këtë punë vullnetarisht pasi mjedisi rrotull saj është i mbushur me armiqësi, mungesë respekti dhe paga qesharake. Por është i vetmi shans që ajo ka për të mbijetuar. Ajo e urren punën e saj, por detyrohet të shkojë çdo ditë. Në të njëjtën kohë, i duhet të ecë për më tepër se 1 orë për të shkuar në punë, plus 8 orë të tjera qëndrim në këmbë, duke u ndjerë e rraskapitur në fund të ditës.

2. Megjithatë paga minimale në Shqipëri është 22,000 Lek/158 Euro në muaj, ajo nuk merr asnjëherë më tepër se 20,000 Lek/142 Euro në muaj. Ndërkohë është e zhytur në borxhe të cilat nuk mund t'i shlyejë. Për shkak të pamundësisë për të paguar faturat e energjisë elektrike ka nënshkruar një kontratë 8 vjeçare me kompaninë të cilës duhet t'i paguajë 2,500 Lek/18 Euro çdo muaj përveç faturës mujore. Pasi paguhet energjia elektrike pak mbetet për ushqime dhe nevoja të tjera. Kur ishte më e re Ana ëndërronte të bëhej infermiere, por babai i saj tepër tradicional nuk e lejoi të shkonte në shkollë të mesme (ai mendonte se vajzat nuk duhet të linin shtëpinë për të shkuar në shkollë). Këtë pasion është përpjekur t'ja kalojë djalit të saj i cili ka dëshirë të bëhet dentist kur të rritet, në mënyrë që të ndihmojë njerëzit e tjerë.

MARIA (EMRI NDRYSHUAR) (23): "NËSE NUK DO MBËSHTETESHA TEK PAGA DO TË DILJA TË PROTESTOJA PËR KUSHTE MË TË MIRA JETESE"

Familja e Marias përbëhet nga 6 persona, 3 prej të cilëve punojnë. Ishte më e vështirë kur familja kishte 9 anëtarë, prindërit e saj dhe 7 vëllezër e motra, dhe vetëm babai i saj punonte me një pagë më të vogël se 300 euro për të mbajtur familjen e madhe. E kuptueshme që ishte e vështirë për të të ofronte edhe nevojat më bazike të familjes.

Maria dhe familja e saj kanë migruar nga Kukësi në Durrës në vitin 1994 në kërkim të kushteve më të mira të jetesës dhe mundësi punësimi. Një karakteristikë e përbashkët e grave që janë vendosur në këtë zonë është mungesa e arsimit formal ose për shkak të familjes tradicionale ose për shkak të mungesës së mundësive, për shembull arsimit i lartë ndalohej nga anëtarët e tjerë meshkuj të familjes.

Në moshën 14 vjeçare asaj iu desh t'i nënshtrohej një operacioni për heqjen e një gjendre që i vështirësonte të folurën dhe të ushqyerin. Ky operacion i kushtoi familjes së saj 5,000 euro. Për këtë arsye paga e mamasë së saj përdoret për të kthyer borxhin e marrë për operacionin. Me pagën e saj mbulohen shpenzimet ditore dhe me pagën e babait shpenzime të tjera si transporti, veshjet, shëndeti dhe arsimit. Për fat të mirë motra e saj përfiton nga një bursë shtetërore prej 9,000 lekësh në muaj.

Pavarësisht vështirësive dhe pengesave me të cilat është përballur gjatë rritjes Maria dhe motrat e saj kanë punuar në fabrika këpucësh për të siguruar mjaftueshëm të ardhura për të mbuluar shpenzimet e tyre personale dhe të shkollimit në mënyrë që të mos i bëhen barrë familjes. Për rrjedhojë shpesh i është dashur të marrin borxh për të paguar fatura të ndryshme, duke bërë që borxhet të akumuloheshin me kalimin e kohës, një skenar i njohur ky për familjet shqiptare. Për momentin Maria punon dhe studion Administrim Publik. Miqësitë që ajo ka krijuar përmes punës vullnetare janë tashmë pjesë e jetës së saj dhe e bëjnë në një farë mënyrë të përballojë problemet që has gjatë punës.

Gjithsesi, ajo është optimiste për të ardhmen pasi ende beson se studimet e saj do të hapin dyer në të ardhmen, mundësi që nuk i kanë të gjitha gratë që punojnë në të njëjtën fabrikë me të. Pjesa më e madhe kanë mbetur aty me mendimin se nuk ka opsione të tjera. Një ditë normale në jetën e Marias përbëhet nga zgjimi në orën 5, ndihma ndaj të ëmës për punët e shtëpisë dhe puna deri në 17 e 30 për ta mbyllur me përkujdesjen për motrat e saj më të vogla.

REKOMANDIME

Për punëdhënësit dhe markat/blerësit:

- Respektimi i Kodit të Punës dhe të drejtave të njeriut në vendin e punës.
- Rritja e pagave menjëherë në një pagë neto të paktën 169 Euro/ 23,637 Lek baras me 60% të vijës së varfërisë të pagës mesatare neto.

Për qeverinë shqiptare :

- Implementimi i kodit të punës dhe sigurimi i të drejtave të njeriut në vendin e punës
- Llogaritja e minimumit socio-kulturor dhe vendosja e një niveli të pagës minimale që është mbi këtë minimum
- Vendosja e një organi tripalësh me fuqi vendimmarrëse (veçanërisht mbi pagën minimale)
- Mbështetja e një sistemi të qendrave që ofrojnë këshillime ligjore falas aty ku është përqendruar industria e veshmbathjeve. Këto qendra duhet të drejtohen nga organizatat e punës dhe të drejtat e njeriut
- Mbështetja e një fushate dhe plani kombëtar veprimi për të drejtat në vendin e punës, të drejtat e grave dhe të drejtat e njeriut në përgjithësi.

1. Përlllogaritje e INSTAT (Republika e Shqipërisë, Instituti i Statistikave)
2. Shifrat ndryshojnë në mënyrë drastike. Megjithatë, zgjodhëm të përdorim ato të INSTAT: 748 veshje, 190 këpucë. Nuk ka të dhëna koherente për numrin e punonjësve në industrinë e veshmbathjeve. Dhoma e Fasonerisë përlllogaritç 36,947 në sektorin e tekstileve/veshjeve dhe 29,688 në sektorin e këpucëve. Burime të tjera variojnë nga 26,000 në 87,000 punëtorë në të dy sektorët.
3. <http://aida.gov.al/pages/clothing-and-shoes>, accessed 15 March 2016
4. Sondazhi i forcës punëtore, INSTAT, 2015
5. Instituti i Statistikave të Shqipërisë, (INSTAT, 2015). Tregu i punës, 2014, Instituti i Statistikave të Shqipërisë (INSTAT, 2015). Tregtia e jashtme 2010-2014.
6. Të gjitha konvertimet: Oanda, 1/1/2016
7. Tregu i Punës, INSTAT_2015: Paga mesatare mujore bruto për vitin 2015 është 46,829 LEK ndërkohë që paga neto është 39,396 Lek. 60% = 23,637 ALL, <http://www.instat.gov.al/publications/librat/2016/tregu-i-pun%C3%ABs,-2015.aspx>
8. Nuk ka data koherente mbi pagat mesatare mujore në sektorin prodhues. Për shpenzimet minimale familjare gjithashtu nuk ka të dhëna të besueshme.
9. Filloreta Kodra: Albania: Urgent need for wage reforms 27, tek: Schmidt, Verena, Vaughan-Whitehead, Daniel (2011): The Impact of the Crisis on Wages in South-East Europe. ILO Geneva, f. 40
10. Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve AIDA, marrë në 15 mars 2016 <http://aida.gov.al/pages/clothing-and-shoes>
11. Strategjia e Biznesit Shqiptar dhe Zhvillimit të Investimeve 2014-2020
12. http://www.albania-textile.com/Materiale/Nentor2012/Presentation%20Gjergji%20Gjika_Prodho%20dhe%20vishu%20shqip.pdf: Dhoma e Fasonëve ka për qëllim të inkurajojë përmirësimet në legjislacionin e sektorit të fasonerisë.
13. Avokati i Popullit mbron të drejtat, liritë dhe interesat ligjorë të çdo individi nga administrata që nuk zbaton ligjin. Cdo individ apo grup individësh (duke përfshirë të miturit) mund t'i drejtohet këtij personi. Ai supozohet se qendron mbi qeverinë. Në Shqipëri Avokati i Popullit zgjidhet nga Parlamenti çdo 5 vite dhe një Komisioner Kundër Diskriminimit po për 5 vite. Avokati i Popullit aktualisht ka marrë fonde nga qeveria daneze.
14. Filloreta Kodra: Albania: Urgent need for wage reforms 27, tek: Schmidt, Verena, Vaughan-Whitehead, Daniel (2011): The Impact of the Crisis on Wages in South-East Europe. ILO Geneva, f. 36
15. http://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---europe/---ro-geneva/---sro-budapest/documents/publication/wcms_250834.pdf
16. Schmidt, Verena, Vaughan-Whitehead, Daniel (2011): The Impact of the Crisis on Wages in South-East Europe. ILO Geneva: http://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---europe/---ro-geneva/---sro-budapest/documents/publication/wcms_172434.pdf

AUTORËT DHE STUDIUESIT

Mirela Arqimandriti, Megi Llubani, Artemisa Ljarja (Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim)

Dr. Bettina Musiolek, Koordinatore e CCC për vendet e Evropës me paga të ulëta

Christa Luginbühl, CCC-Switzerland / Berne Declaration